



MES MOHIMIT DHE REAGIMIT: PERCEPTIMET E QYTETARËVE MBI MENAXHIMIN E COVID-19 NGA INSTITUCIONET E KOSOVËS



2020 EDICIONI I PARË
RAJONAL I ANKETËS



Interpretimi i të dhënave:

Plator Avdiu

Metodologjia dhe rishikimi i brendshëm:

Mentor Vrajolli

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e përgjigjeve të mbledhura nga të anketuarit dhe demonstrojnë vetëm mënyrën se si qytetarët i perceptojnë institucionet. Ato në asnjë mënyrë nuk paraqesin ndonjë vlerësim përfundimtar të punës së institucioneve që shqyrtohen në këtë studim. Raporti do të shërbejë si instrument për të adresuar mangësitë e mundshme, por edhe si tregues i efektivitetit të komunikimit të tyre me njerëzit.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptimet e të anketuarve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë apo të donatorëve të saj.

PROJEKTI MBËSHTETET NGA:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

MES MOHIMIT DHE REAGIMIT: PERCEPTIMET E QYTETARËVE MBI MENAXHIMIN E COVID-19 NGA INSTITUCIONET E KOSOVËS

Qershor 2021, Prishtinë

PËRMBAJTJA



GJETJET KRYESORE.....	1
HYRJE	3
1. KEQMENAXHIMI I KRIZËS SË COVID-19 NGA INSTITUCIONET E KOSOVËS? .	4
1.1. Rekomandime	6
2. NDIKIMI SOCIO-EKONOMIK I PANDEMISË COVID-19 NË KOSOVË	7
2.1. Rekomandime	8
3. PERCEPTIMI I PÛRKRAHJES DHE NDIKIMIT TË JASHTËM NË KOSOVË GJATË PANDEMISË COVID-19	9
3.1. Rekomandime.....	13



GJETJET KRYESORE

- Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve në Kosovë dyshon në ekzistencën e virusit COVID-19: rreth 34 përqind nuk besonin se virusi ekziston, krahasuar me 64 përqind që besojnë se ky virus ekziston.
- Institucionet qendrore të Kosovës (Kuvendi, Qeveria dhe Presidenti) perceptohen nga të anketuarit si mjaft të dobëta ose shumë të dobëta në lidhje me menaxhimin e situatës së pandemisë COVID-19.
- Nga ana tjetër, Policia e Kosovës (74 përqind), institucionet shëndetësore publike/spitalet (68 përqind) dhe komunat (61 përqind) vlerësohen shumë pozitive nga të anketuarit për punën e tyre në menaxhimin e krizës së pandemisë.
- Shumica e të anketuarve (53 përqind) pohuan se situata e pandemisë është menaxhuar më mirë gjatë periudhës mars-qershor 2020 që përkon me kohën kur qeveria drejtohej nga kryeministri i atëhershëm Albin Kurti. Sidoqoftë, një numër shumë më i vogël i të anketuarve - 15 përqind gjithsej - besonin se kriza shëndetësore u menaxhua më mirë nga Qeveria e drejtuar nga ish-Kryeministri Avdullah Hoti në periudhën qershor-shtator 2020.
- Pasojat negative të shkaktuara nga pandemia e koronavirusit, përfshirë ndikimin në ekonomi dhe shëndetin mendor, janë përmendur nga 71 përqind e të anketuarve. Megjithatë, rreth 29 përqind e tyre pohuan se nuk janë përballë me ndonjë ndikim negativ për shkak të COVID-19.
- Rimëkëmbja ekonomike është dhe do të mbetet çështja më sfiduese e shkaktuar nga COVID-19 - gati të gjithë të anketuarit (95 përqind) u përgjigjën se situata e pandemisë do të ndikojë negativisht në ekonominë e Kosovës.
- Vetëm 31 përqind e të anketuarve të intervistuar pohuan se demokracia është prekur nga masat parandaluese dhe të përkujdesjes për COVID-19 të vendosura nga institucionet shtetërore të Kosovës krahasuar me 46 përqind që pohojnë se pandemia nuk kishte kurrfarë ndikimi në demokraci. Kjo nënkupton që çështjet e lidhura me demokracinë nuk janë shqetësimi kryesor për qytetarët e Kosovës kur krahasohen me rimëkëmbjen ekonomike.

● Sa i përket mbështetjes ndërkombëtare, 29 përqind e të anketuarve kishin ndjenjën se Shtetet e Bashkuara i kanë dhënë mbështetjen më të madhe financiare dhe humanitare Kosovës për ballafaqim me situatën e pandemisë, ndërsa mbështetësi i dytë më i madh ka qenë Gjermania (20 përqind). Këto pasohen nga Bashkimi Evropian (12 përqind) dhe Turqia (10 përqind).

● Roli i partnerëve ndërkombëtarë të Kosovës përgjatë krizës së pandemisë COVID-19 është perceptuar përgjithësisht pozitiv nga të anketuarit. Kështu, e para në listë nga të anketuarit renditet Gjermania (74 përqind) e pasuar nga Shtetet e Bashkuara (64 përqind), Bashkimi Evropian (62 përqind), Turqia (58 përqind) dhe Mbretëria e Bashkuar (49 përqind).

● Ndërkohë, vendet të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, si Kina (55 përqind) dhe Rusia (48 përqind) perceptohen të kenë ushtruar ndikim politik kryesisht negativ ndaj Kosovës gjatë situatës së koronavirusit.

HYRJE

Ky raport shqyrton qëndrimet dhe perceptimet e qytetarëve të Kosovës mbi pandeminë e koronavirusit me qëllim që të zbërthejë mendimet e të anketuarve rreth çështjeve më aktuale në lidhje me situatën e COVID-19 në Kosovë. Seksioni i parë i raportit shqyrton nëse të anketuarit kosovarë besojnë në ekzistimin e pandemisë COVID-19, si dhe interpreton edhe perceptimet mbi mënyrën se si institucionet e Kosovës e kanë menaxhuar situatën e COVID-19 në periudhën mars-shtator 2020. Seksioni i dytë shqyrton shkallën në të cilën COVID-19 ka ndikuar në jetën e përditshme të qytetarëve nga pikëpamja socio-ekonomike e deri te të drejtat e njeriut. Ndërsa, seksioni i tretë i raportit analizon perceptimet mbi ndikimin politik të vendeve/organizatave të huaja kundrejt Kosovës në trajtimin e COVID-19 si dhe ndihmën e tyre financiare e humanitare për Kosovën gjatë krizës së koronavirusit në Kosovë.

Sikurse dihet, një numër i konsiderueshëm i qytetarëve në Kosovë kishin dyshime dhe ishin mosbesues ndaj ekzistimit të pandemisë së koronavirusit. Kjo ishte më e shprehur gjatë fazave të hershme të situatës së pandemisë, kur disa figura publike po bënin fushatë kundër masave parandaluese dhe mbrojtëse të Qeverisë së Kosovës kundër përhapjes së sëmundjes koronavirusit në vitin 2020. Kjo me sa duket ishte motivuar nga qarkullimi i dhjetëra lajmeve me tematikë konspirative dhe pseudoshkencore nëpër mediat kosovare që pohonin se pandemia COVID-19 nuk ekziston. Prandaj, qytetarët kishin prirje të besonin në fushatën konspirative dhe dezinformuese. Kjo shpjegon pse 1/3 e qytetarëve të intervistuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) përmes kësaj ankete gjatë muajve shtator-tetor 2020 u përgjigjën se nuk besojnë në ekzistimin e pandemisë COVID-19.

Për më shumë, QKSS vendosi të masë perceptimet e të anketuarve mbi këtë çështje specifike, si dhe mbi punën e institucioneve qendrore, lokale, të sigurisë dhe të shëndetit publik në lidhje me menaxhimin e situatës së pandemisë COVID-19, në mënyrë që të zbulojë perceptimet mbi këto çështje. Veç kësaj, kjo anketë mati edhe ndikimin socio-ekonomik të pandemisë COVID-19 në Kosovë dhe perceptimet lidhur me mbështetjen/ndikimin e jashtëm në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19.

Vlen të përmendet se perceptimet e paraqitura në këtë raport u mblodhën nga Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS), një mjet i veçantë ky përmes të cilit QKSS për çdo vit mat perceptimet e publikut në Kosovë mbi besimin ndaj institucioneve dhe mbi çështje të lidhura me sigurinë, përfshi situatën e pandemisë në Kosovë. Në edicionin e dhjetë, BKS ka marrë përmasë rajonale dhe shënon edicionin e parë të Barometrit të Sigurisë së Ballkanit Perëndimor (BSBP) të zbatuar njëkohësisht në Kosovë dhe në Serbi në shtator-tetor 2020.¹

¹ Metodologjia për realizimin e anketës mund të gjendet në raportin e mëparshëm të publikuar nga QKSS në këtë vegëz: http://www.qkss.org/repository/docs/WBSB_KosovoReport_Alb_final_988743.pdf

1. KEQMENAXHIMI I KRIZËS SË COVID-19 NGA INSTITUCIONET E KOSOVËS?


Duke pasur parasysh dyshimet e qytetarëve kosovarë ndaj ekzistencës së pandemisë COVID-19, QKSS ka paraqitur në pyetësin e anketës një varg pyetjesh të paracaktuara, kushtuar kryesisht situatës së pandemisë por edhe një pyetje të hapur. Prandaj, kjo pjesë e raportit përfshin perceptimet mbi ekzistimin e sëmundjes COVID-19 dhe mendimet e të anketuarve mbi punën e institucioneve shtetërore për menaxhimin ose keqmenaxhimin e krizës së pandemisë. Opinionet e të anketuarve janë të rëndësishme në këtë drejtim dhe synojnë të analizojnë nga perspektiva e të anketuarve çështjet më aktuale lidhur me situatën COVID-19 në Kosovë gjatë vitit 2020 (mars - tetor 2020).


Anketa e kryer në Kosovë ka dëshmuar se 1/3 e të anketuarve (34 përqind e tyre) kanë dyshime mbi ekzistencën e sëmundjes COVID-19. Kjo mund të vijë si shkak i shumë burimeve të informacionit që qarkullojnë nëpër mediat vendase dhe të huaja në internet dhe rrjetet e mediave sociale që kanë plasuar dezinformata ose informata me përmbajtje konspirative sa i përket pandemisë. Sidoqoftë, më shumë se gjysma e të anketuarve kosovarë e kanë kundërshtuar këtë pikëpamje, pasi 64 përqind e tyre u përgjigjën se COVID-19 ekziston.



Menaxhimi i situatës së pandemisë nga institucionet qendrore të Kosovës nuk perceptohet mirë nga pothuajse shumica e të anketuarve, krahasuar me institucionet e tjera që janë drejtpërdrejt të përfshira në parandalimin e pandemisë. Prandaj, Policia e Kosovës është vlerësuar më pozitivisht nga 74 përqind, institucionet shëndetësore duke përfshirë spitalet me 68 përqind dhe komunat me 61 përqind gjithsej.

FIGURA 2 PERCEPTIMET SE SI INSTITUCIONET E KOSOVËS E MENAXHUN SITUATËN E PANDEMISË COVID-19







Shumica e të anketuarve (53 përqind) pohuan se situata e pandemisë u menaxhua më mirë në periudhën para qershorit të vitit 2020, duke nënkuptuar periudhën kur Qeveria e Kosovës drejtohej nga kryeministri i atëhershëm Albin Kurti (shkurt-qershor 2020). Gjatë kësaj periudhe vendi kaloi nën masa të forta izolimi të vendosura nga Qeveria, ndërsa numri i rasteve të infektuara dhe i vdekjeve ishte dukshëm më i ulët.

Nga ana tjetër, vetëm 15 përqind e qytetarëve u përgjigjën se pandemia u menaxhua më mirë në kohën që korrespondon me masat e ndërmarra nga kabineti qeveritar i sapoformuar atëherë nën ish-kryeministrin Avdullah Hoti (kjo përfshinte periudhën qershor-shtator 2020, ndërsa hulumtimi në terren për këtë anketë ishte realizuar nga ekipi i QKSS në shtator-tetor 2020). Kjo e fundit i lehtësoi masat parandaluese gjatë pandemisë, por numri i personave të infektuar dhe i vdekjeve filloi të rritej me shpejtësi në Kosovë.

FIGURA 3 PERCEPTIMET SE NË CILËN PERIUDHË U MENAXHUA MË MIRË SITUATA E PANDEMISË NË KOSOVË



Të anketuarit dhanë mendimet, sugjerimet dhe rekomandimet se çka duhej të ishte bërë nga institucionet shtetërore për menaxhim më të mirë të situatës me COVID-19 në vend. E para në listë, e shprehur nga 24 për qind e të anketuarve, është zbatimi i masave parandaluese dhe vigjilenca e qytetarëve kundër infeksionit me koronavirus. Ajo pasohet nga masa më të rrepta dhe ndëshkime ndaj atyre që nuk zbatojnë masat (16 për qind), ndihma shtetërore për qytetarët (11 për qind), angazhimi më i madh i Qeverisë (10 për qind), stabiliteti politik (10 për qind) dhe përgjigjet e tjera, siç jepet nga figura vijuese.



1.1. REKOMANDIME

- Ndonëse një numër i konsiderueshëm i të anketuarve kishte dyshime mbi ekzistencën e COVID-19, institucionet e Kosovës në nivelin lokal dhe qendror, si dhe organizatat joshtetërore (mediat, organizatat joqeveritare etj.) duhet të ndërmarrin fushata informimi dhe të vetëdijesimit publik mbi domosdoshmërinë e vaksinimit masiv të popullatës kundër virusit COVID-19. Kjo do të kontribuonte në uljen e numrit të atyre që refuzojnë ose shfaqin hezitim për të marrë vaksinat.
- Përderisa popullata nuk vaksinohet kundër sëmundjes COVID-19, qytetarët, institucionet dhe organizatat shtetërore/joshtetërore duhet t'i zbatojnë rregullat e institucioneve shëndetësore të Kosovës për mbajtjen e maskave, mbajtjen e distancës fizike dhe higjienën e mirë personale në mënyrë që të zvogëlojnë dhe ta shmangin përhapjen e kësaj sëmundjes infektive.

2. NDIKIMI SOCIO-EKONOMIK I PANDEMISË COVID-19 NË KOSOVË

Ngjashëm si të gjitha vendet e prekura nga pandemia, Kosova aktualisht po përballet me sfida të rënda dhe pasojat e dala nga kriza e pandemisë. Kjo u konfirmua nga përgjigjet e të anketuarve në anketë që pohuan se sfidat kryesore janë ato të natyrës socio-ekonomike. Për më tej, pyetësi i zhvilluar nga QKSS përfshiu tri pyetje të hapura mbi ndikimin e pandemisë në jetën e përditshme të qytetarëve.


Në parim, shumica e qytetarëve ose 71 përqind, vlerësojnë se pandemia ka ndikuar negativisht në jetën e tyre, duke përfshirë ndikimin negativ në kushtet ekonomike dhe shëndetin mendor. Ndërsa, 29 përqind e të anketuarve deklaruan se COVID-19 nuk kishte ndonjë ndikim negativ kundrejt tyre.

FIGURA 5 NDIKIMI I SITUATËS SË PANDEMISË NË JETËN E QYTETARËVE (PYETJE E HAPUR)




Shkoqitja e perceptimeve të të anketuarve vë në pah se rimëkëmbja ekonomike do të jetë çështja më sfiduese e shkaktuar nga pandemia. Pothuajse të gjithë të anketuarit e intervistuar (95 përqind) theksuan se situata e koronavirusit do të ndikojë negativisht në ekonominë e vendit.

FIGURA 6 NDIKIMI I SITUATËS SË PANDEMISË NË EKONOMINË E KOSOVËS (PYETJE E HAPUR)



Përkundër vendimeve të marra nga institucionet e Kosovës kundër përhapjes së COVID-19 (si karantina, bllokimi, kufizimi i lirisë së lëvizjes etj.), pothuajse shumica e të anketuarve (46 përqind në total) nuk mendonin se pandemia ka pasur ndonjë ndikim në demokracinë në Kosovë. Nga ana tjetër, rreth 31 përqind e të anketuarve konsideruan se pandemia ka ndikuar tek demokracia përmes kufizimit të lirisë së lëvizjes (16 përqind), paqëndrueshmërisë politike (7), ndikimit negativ në demokraci dhe jetës së qytetarëve (5 përqind), si dhe ndikimit negativ në ekonomi (3 përqind). Ata që nuk kishin një mendim për këtë pyetje të hapur ishin gjithsej 23 përqind e të anketuarve.

FIGURA 7 NDIKIMI I SITUATËS SË PANDEMISË NË DEMOKRACINË NË KOSOVË (PYETJE E HAPUR)



2.1. REKOMANDIME

- Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës dhe odat/shoqatat ekonomike duhet të paraqesin një plan të ri gjithëpërfshirës socio-ekonomik të rimëkëmbjes ose të përditësojnë planin aktual të rimëkëmbjes për përfshirjen e grupeve më të prekshme që kanë pësuar për shkak të masave kufizuese kundër COVID-19.


3. PERCEPTIMI I PËRKRAHJES DHE NDIKIMIT TË JASHTËM NË KOSOVË GJATË PANDEMISË COVID-19

Kjo anketë ka matur perceptimet e të anketuarve për përkrahjen e ofruar për Kosovën nga vendet dhe organizatat e huaja nga njëra anë, si dhe ndikimin politik të vendeve të huaja ndaj Kosovës gjatë krizës së pandemisë nga ana tjetër. Ideja prapa pyetjeve të tilla ishte që të merreshin reagimet e drejtpërdrejta nga të anketuarit duke marrë parasysh që kjo pjesë përfshin një pyetje të hapur dhe një pyetje tjetër të mbyllur. Në këtë drejtim, njëri nga qëllimet e këtij edicioni të anketimit ishte të përcaktojë ndikimin e jashtëm dhe përkrahjen ndërkombëtare për Kosovën sipas perspektivës së qytetarëve. Bazuar në përgjigjet e marra nga të anketuarit, është me interes të theksohet se mbështetja ndërkombëtare dhënë për Kosovën (në pajisje, ndihma financiare etj.) ka ardhur kryesisht nga ato vende partnere që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe të cilat perceptohen se ushtrojnë dukshëm ndikim pozitiv në vend.

Rrjedhimisht, përkrahja ndërkombëtare gjatë krizës së COVID-19 ka qenë e vazhdueshme për Kosovën kryesisht nga vendet partnere të huaja dhe organizatat ndërkombëtare me qëllim të ballafaqimit me sfidat e pandemisë sa i përket pajisjeve shëndetësore dhe sigurimit të ndihmës financiare për institucionet shtetërore.

Përmes një pyetje të hapur, 29 përqind e të anketuarve pohuan se deri më tani (anketimi me qytetarë është bërë në periudhën shtator-tetor 2020) Shtetet e Bashkuara kanë siguruar mbështetjen më të madhe financiare dhe humanitare për Kosovën në ballafaqimin e situatës së pandemisë. Vendi i dytë është i rezervuar për Gjermaninë nga 20 përqind e të anketuarve që e perceptojnë atë si mbështetësin e dytë më të madh për Kosovës gjatë pandemisë. Ajo ndiqet nga Bashkimi Evropian (12 përqind) dhe Turqia (10 përqind) si mbështetësit më të mëdhenj të Kosovës pas Shteteve të Bashkuara dhe Gjermanisë.

FIGURA 8 CILI SHITET/ORGANIZATË I KA DHËNË MBËSHTETJEN MË TË MADHE FINANCIARE/HUMANITARE KOSOVËS NË TRAJTIMIN E PANDEMISË COVID-19 (PYETJE E HAPUR)?





Rezultate po aq me rëndësi hasen edhe kur analizohet pyetja e mbyllura në lidhje me këtë çështje. Siç pritej, rezultatet ishin shumë pozitive kur bëhet fjalë për vendet që kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe që vazhdimisht e mbështesin Kosovën në menaxhimin e situatës së pandemisë COVID-19. Megjithatë, ndryshe nga rezultatet e pyetjes së hapur, kur u mat pyetja e mbyllur, renditja ishte pakëz e ndryshme. Gjermania mori perceptimet më pozitive me 74 përqind që pohuan se ndikimi i saj gjatë COVID-19 ka qenë shumë pozitiv. Ky perceptim pozitiv mund të lidhet kryesisht me një numër të madh të diasporës së Kosovës që jeton në Gjermani dhe mbështetja e të cilës ndaj familjarëve të tyre në Kosovë vazhdoi edhe gjatë situatës së pandemisë. Sidoqoftë, këto perceptime pozitive mund t'i atribuohen edhe mbështetjes së drejtpërdrejtë që Kosova mori nga shteti gjerman gjatë pandemisë dhe jo vetëm gjatë saj. Ndërkohë, ShBA-ja që ka qenë shumë aktivisht e angazhuar në zhvillimet politike të Kosovës, veçmas në lidhje me dialogun politik me Serbinë, doli e dyta me 64 përqind. Brenda pesë më të mirëve rezultoi edhe Bashkimi Evropian (me 62 përqind), Turqia (me 58 përqind) dhe Mbretëria e Bashkuar (me 49 përqind).

Ndërkohë, siç u vu re më lart, rezultatet e anketës tregojnë se vendet mosnjohëse të pavarësisë së Kosovës kryesisht nuk perceptohen pozitivisht nga të anketuarit kosovarë, ndërsa edhe nëse ato nuk perceptohen negativisht, të anketuarit janë të paktën të pavendosur ndaj tyre. Në këtë drejtim, Kina perceptohet negativisht nga 55 përqind prej tyre në lidhje me trajtimin e situatës COVID-19 dhe Rusia nga 48 përqind përkatësisht. Arsyeja pse ekziston ndryshimi në perceptimin e Kinës dhe Rusisë është se 32 përqind e të anketuarve nuk e dinin ose nuk kishin informacion në lidhje me rolin e Rusisë kundrejt Kosovës gjatë pandemisë COVID-19. Nga ana tjetër, shumica dërrmuese e të anketuarve janë të pavendosur mbi rolin e Iranit meqë 60 përqind e të anketuarve nuk dinin për rolin e Iranit në raport me Kosovën gjatë krizës së COVID-19, megjithëse përqindja e


atyre që e perceptojnë atë si pozitiv (3 përqind) është pakrahasueshëm më e ulët sesa ata që e shohin ndikimin e saj si negativ (25 përqind) duke pasur parasysh se Irani nuk e njih pavarësinë e Kosovës.


FIGURA 9 PERCEPTIMET MBI NDIKIMIN POLITIK TË VENDEVE/ORGANIZATAVE TË HUAJA NDAJ KOSOVËS NË MENAXHIMIN E SITUATËS SË PANDEMISË COVID-19







3.1. REKOMANDIME


 Institucionet e Kosovës duhet të jenë këmbëngulëse në zhvillimin dhe fuqizimin e bashkëpunimit dypalësh (bilateral) me vendet partnere, të cilat perceptuara me ndikim shumë pozitiv nga të anketuarit. Në këtë drejtim, QKSS rekomandon si më poshtë këto forma të bashkëpunimit me vendet partnere:


 Marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë janë të dyfishta për shkak të: i) përqendrimit të madh të komunitetit të diasporës kosovare që jeton në Gjermani dhe ii) kontributit të rëndësishëm të Gjermanisë në Kosovë në dekadat e fundit. Prandaj, shteti i Kosovës duhet të shfrytëzojë plotësisht këtë potencial në mënyrë që të avancojë marrëdhëniet dypalëshe me Gjermaninë dhe institucionet e saj në drejtim të agjendës politike, ekonomike dhe integritit në BE.


 Marrëdhëniet bilaterale dhe diplomatike të Kosovës me Shtetet e Bashkuara janë shumë të rëndësishme për integrimin euro-atlantik të Kosovës dhe kontributin e dhënë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Kosovë në fusha të ndryshme me interes të përbashkët. Qeveria e Kosovës duhet të shqyrtojë më tej mundësitë e thellimit të marrëdhënieve bilaterale me Shtetet e Bashkuara. Përveç anëtarësimit në strukturat euro-atlantike (pra, anëtarësimin e Kosovës në NATO), Kosova duhet të bashkëpunojë ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për procesin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare (si INTERPOL etj.) dhe të kërkojë përfshirjen e mëtejshme dhe aktive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në dialogun e lehtësuar nga BE-ja mes Kosovës dhe Serbisë.

 Përveç dialogut të vazhdueshëm me Serbinë, të lehtësuar nga BE-ja, Qeveria e Kosovës duhet të këmbëngulë për ta ngritur agjendën e integritit të BE dhe të bashkëpunojë me vendet hezituese të BE-së (Francën, Holandën dhe Danimarkën) për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës për të pasur mundësi për udhëtim pa viza në BE. Sa i përket vaksinimit kundër sëmundjes COVID-19, institucionet e Kosovës duhet të përdorin vetëm vaksinat e autorizuara nga Agjencia Evropiane e Mjekësisë si më efektivet.

 Nga ana tjetër, Qeveria e Kosovës duhet të identifikojë fushat e bashkëpunimit me Turqinë dhe të mirëmbajë raporte të partneritetit të barabartë e konstruktiv për çështje praktike.

 Kur bëhet fjalë për Mbretërinë e Bashkuar, Kosova duhet të fuqizojë marrëdhëniet dypalëshe për çështjet e sigurisë, mbrojtjes, politike dhe ekonomike. Kontributi i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë është shumë i rëndësishëm për anëtarësimin e vendit në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, si NATO, INTERPOL, UNESCO etj.

 Edhe pse perceptimet e të anketuarve në Kosovë kanë qenë mjaft neutrale ndaj Francës, kjo e fundit është aleat i rëndësishëm i Kosovës në procesin e anëtarësimit në BE dhe dialogun Kosovë-Serbi. Ekziston një potencial i madh për ta përfshirë bashkëpunimin me Francën në një gamë të gjerë çështjesh. Prandaj, institucionet shtetërore kosovare duhet të punojnë në mënyrë reciproke me Francën në procesin e liberalizimit të vizave dhe për tema të tjera që lidhen me integrimin në BE.

 Sa i përket vendeve joperëndimore (si Rusia, Kina, Irani etj.), Kosova duhet të harmonizojë agjendën ndërkombëtare me qëndrimet e Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

616.9(496.51)(047)

Mes mohimit dhe reagimit: perceptimet e qytetarëve mbi menaxhimin e COVID-19 nga institucionet e Kosovës / interpretimi i të dhënave Plator Avdiu ; metodologjia dhe rishikimi i brendshëm Mentor Vrajolli. - Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2021. - 13 f. : ilustr. ; 22 cm.

Sëmundjet ngjitëse -- COVID-19 -- 2020 -- Raportet -- Kosovë

ISBN 978-9951-799-38-6

Aleph [000098001]



ISBN 978-9951-799-38-6



9 789951 799386